



ISO-POLIFONIA

“Kryevepër e trashëgimisë gojore dhe shpirtërore të njerëzimit”, UNESCO



“A Masterpiece of oral and intangible heritage of humanity”


www.isopolifonia.com

Newsletter; Nëntor 2009, Nr. 1



Maksi Velo, pikturë "Grupi iso-polifonik Lab"

“Iso-polifonia popullore shqiptare, shpallet “Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit”, mbrojtur nga UNESCO Unesco, Paris 25 Nëntor, 2005



Çertifikata e shpalljes së Iso-polifonisë si “Kryevepër e trashëgimisë gojore dhe shpirtërore të njerëzimit”, UNESCO

Pa më të voglin dyshim, data 25 nëntor 2005 është një ditë historike për mbarë trashëgiminë kulturore të shqiptarëve por dhe për vetë Shqipërinë. Në këtë ditë “Iso-polifonia popullore shqiptare” futet në listën e “Kryeveprave të trashëgimisë gojore të njerëzimit” mbrojtur nga UNESCO, fakt që u kumtua në të gjitha mediat e botës nga Dr. Koichiro Matsuura, Drejtor i Përgjithshëm i UNESCO-s, nga selia qëndrore e UNESCO-s në Paris. Për të dale me këtë vendim, Juria Ndërkombëtare e mbledhur në Paris nga data 21-24 Nëntor 2005, shqyrtoi mbi 60 kandidatura të propozuara për t’u përfshirë në listën “Kryevepër e njerëzimit”, propozime të bëra në rrugë zyrtare nga shtete të ndryshme në çdo anë të botës duke plotësuar dosjet dhe kriteret e shpallura për këtë qëllim.


Nga sot “Iso-polifonia” jonë popullore, kjo dukuri e jashtëzakonshme e të konceptuarit dhe e komunikimit njerëzor është vendosur në vendin që meriton: në listën e kryeveprave të botës shpirtërore të njerëzimit. Kjo listë e kryeveprave në thelb përbëhet nga

fenomene dhe shfaqje dukurish të kulturave shpirtërore të popujve të ndryshëm të botës të cilat qëndrojnë në themel të kulturës njerëzore, dhe që dallohen për frymën dhe llojin unikal që ato përfaqësojnë. Ndër to përmendim: makamet e Irakut, operan e Pekinit, vedat indiane etj. Për të arritur këtë rezultat, u desh të ndiqej një procedurë tepër rigoroze e plotësimit të dosjes së kandidimit të “Iso-polifonisë”. Dosja, e përgatitur nga ne, mbështetur kriterëve të shpallura nga UNESCO, ndër të tjera, përmbante:

Mbështetur këtij konfirmimi të rëndësishëm për vlerat që mbart trashëgimia shpirtërore shqiptare, mund të themi me plot gojë se kultura shqiptare në tërësi po shndërrohet në faktorin nr. 1 të integritimit evropian dhe të imazhit pozitiv për Shqipërinë. Nuk është e pakët që në këto vitet e fundit vetëm në fushën e njohjes ndërkombëtare të vlerave të trashëgimisë kulturore

kemi: Parkun kombëtar të Butrintit, qytetin e Gjirokastrës dhe qytetin e Beratit, si “Pasuri kulturore e njerëzimit” mbrojtur nga UNESCO.

Vetë shteti shqiptar ka hartuar dhe implementuar ligje të reja për këtë fushë sic është ai “Për trashëgiminë kulturore”- 2003 apo



“Për muzetë” 2005, por edhe është bërë gjithashtu pjesë e standarteve globale ndër të tjera edhe duke aprovuar pothuaj të gjitha konventat ndërkombëtare në këtë fushë. Së fundi pritet nënshkrimi aproves formal i konventës së UNESCO-s “Për ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore”, nga ana e Ministrit tonë të Jashtëm, mbas Vendimit që mori Këshilli i Ministrave për njohjen në parim të saj tani së fundi.

Futja e Iso-polifonisë në listën kryevepër që mbrohet nga UNESCO do të sjell një njohje dhe përhapje të mëtijshme në mbarë botën brenda saj. Më shumë kujdes dhe fonde për grupet popullore dhe studimet për iso polifoninë dhe sigurisht më tepër angazhime për kryerjen e aktiviteteve që i kushtohen iso-polifonisë.

Akademik Vasil S. TOLE
 Eksperti i përgatitjes së Dosjes së kandidimit të
 Iso-Polifonisë

Dosja e Iso-polifonisë përmbante:


I. Materiale shkrimore në gjuhën angleze

1. Kërkesën zyrtare të UNESCO’s National Commission of Albania për regjistrimin e iso-polifonisë si “*Masterpiece of the human oral heritage*”.
2. Formulurin e plotësuar të “*Albanian folk iso polyphony*”, fq. 1-29, sipas standarteve dhe modelit të UNESCO-s
3. Bibliografinë e punimeve të autorëve të huaj mbi iso-polifoninë.
4. Bibliografinë e punimeve të autorëve shqiptarë mbi iso-polifoninë.
5. Të dhëna dhe botime zyrtare mbi zonat ku këndohet në iso-polifoni.
6. Draft Aksion Planin 2003-2008 mbi “*Iso-Polifoninë*”.
7. 5 format e tjera të propozuara sic kërkohet në Formën e Aplikimit Tip.
8. Ligjin në gjuhën angleze 9048, dt. 07.04. 2003 “*Për trashëgiminë kulturore*”.
9. Studimin e plotë shkencor mbi iso-polifoninë nga Vasil S. TOLE
10. Studimin “*Odiseja dhe Sirenat, grishje drejt viseve iso-polifonike të Epirit*”, Uegen, 2005, nga Vasil S. TOLE

II. Audio, video materiale dhe libra:

1. Harta të ndryshme të Shqipërisë.
2. 32 fotografi me ngjyra së bashku me negativët të grupeve iso-polifonike shqiptare.
3. Një dokument video 2 orësh i cili ilustron të kënduarin iso-polifonik me zonat si më poshtë:
 - a. *Himara* Lab iso-polyphony
 - b. *Kolonja* Tosk iso-polyphony
 - c. *Tepelena* Lab iso-polyphony
 - d. *Gjirokastra* Tosk iso-polyphony
 - e. *Përmeti* Lab iso-polyphony
4. Një listë të publikimeve audio dhe video që do të shërbejnë në mbështetje të dosjes së paraqitur:
 - a. “*Albania Intangible Heritage in CD*”, Tirana 2004

- b. *Intangible Heritage-Iso-polifonia, Tirana 2003*
 - c. *The polyphonic group “Kristalet e Smokthinës”, Eurostar*
 - d. *The iso-polyphonic group “Djemtë e Vlorës”, Eurostar*
 - e. *The polyphonic group “Ergjëria”, Eurostar*
 - f. *The publication “Popullsia e Shqipërisë” – “Albania’s population”, Tiranë 2001*
5. Një video profesionale e tipit (Betacam SP) e titulluar “*Albanian Iso-polyphony*” ~ 10 minutes’ e cila pasqyron elementet më të rëndësishëm të fenomenit muzikor të iso-polifonisë, përgatitur mbështetur *Annex IV*.
 6. Autorizime dhe dokumenta që provojnë Copyrightin e materialeve të mësipërme/



Fyelltarët nga Ibrahim Kodra



U zhvillua FFK i Gjirokastrës nga dt. 24-29 shtator 2009



“Fjala e hapjes së Festivalit Folklorik Kombëtar, Gjirokastrë 2009”

Nga Ferdinand Xhaferri, Ministër i TKRS



Për një javë rrjesht në skenën madhëshore të kalasë së lashtë, ngritur mbi “piramidën” e vlerave të trashëgimisë kulturore materiale që mbart ansambli arkitekturor monumental i këtij qyteti të veshur e stolisur krejt në gur, do të parakalohjnë artistë dhe artiste, burra, gra, fëmijë e të moshuar nga Shqipëria e Kosova, nga shqiptarët e Malit të Zi dhe Maqedonisë, shqiptarë nga diaspora dhe të tjerë të emigruar në vende të ndryshme të botës. Në këtë “sofër” të këngës dhe valles për gjashtë ditë të këtij festivali do të vërshojë shpirti krijues shqiptar, perlat dhe diamantet e trashëgimisë së pasur shpirtërore të këtij kombi.

Personalisht kam kënaqësinë e veçantë, që në emër të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të përshëndes çeljen e Festivalin Folklorik Kombëtar, Gjirokastrë 2009, si veprimtaria më e rëndësishme e trashëgimisë kulturore shpirtërore shqiptare. Kjo veprimtari, me një rëndësi dhe rezonancë mbarëkombëtare, merr një tingëllim të veçantë edhe për faktin se zhvillohet pikërisht në qytetin që vetëm para pak kohësh u shpall “Pasuri botërore e njerëzimit” mbrojtur nga UNESCO.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore shpirtërore shqiptare, transmetimi dhe konservimi i saj nga brezi në brez ka qënë dhe mbetet një prioritet themelor i politikave kulturore që ndjek MTKRS dhe qeveria Berisha. Trashëgiminë kulturore shqiptare ne e konsiderojmë si gur themeli të qënies dhe të genit shqiptar. Dëshmi e këtij kujdesi është pikërisht organizimi i këtij Festivali si dhe realizimi i përpjekjeve të vazhdueshme e profesionale të MTKRS që kurorëzuan përfshirjen e Gjirokastrës dhe Beratit në trashëgiminë kulturore botërore. Duke vazhduar me profesionalizëm e përkushtim këtë politikë ne jemi të sigurtë se do t’u japim edhe në të ardhmen shqiptarëve

sihariqe të tjera të rëndësishme në fushën e ruajtjes dhe konservimit të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Përpjekjet e vazhdueshme dhe të suksesshme që bëhen për ta ingranuar Shqipërinë sa më shpejt në Evropë, asnjëherë nuk janë ndarë dhe nuk do të ndahen nga përpjekjet për të ruajtur dhe vlerësuar trashëgiminë shpirtërore të çdo populli duke e konsideruar integrimin pasneuropian nëpërmjet diversitetit të kulturave të ndryshme të çdo kombi që e pasurojnë dhe e bëjnë të larmishme kulturën evropiane dhe atë botërore.

Festivali do të jetë gjithashtu një dëshmi e patjetërsueshme e diversitetit dhe pasurisë kulturore që karakterizon botën dhe genin shqiptar. Në këtë veprimtari krijimtaria popullore shqiptare shikohet ashtu siç është në të vërtetë: me ngjyrat e nuancat e të gjithë krahinave brenda Shqipërisë, por edhe me ato të shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe të diasporës shqiptare, që nga ajo më e herëshmjaja dhe deri tek më e reja. Vetë kjo larmi dëshmon për një komb të kulturuar e me integritet evropian.

Festivali do të jetë gjithashtu një dëshmi e gjallë e respektit që ka politika shqiptare për kulturën e

pakicave etnike dhe minoriteteve etno-kulturore që gjallojnë në Shqipëri, duke realizuar kështu një nga parimet bazë të Këshillit të Evropës dhe ndërtimit të Evropës së re. Veprimtaria që nis sot në Gjirokastrë padyshim që do të pasurojë jetën e këtij qyteti dhe mbarë Shqipërisë. E rëndësishme është që kjo veprimtari të mos shikohet dhe të vlerësohet si dikur: thjesht si një muze i mbyllur, me karakter të përkohëshëm dhe propagandistik. Ne e vlerësojmë krijimtarinë që do të shpaloset në skenën e Gjirokastrës si një ekspozitë përherë në lëvizje dhe përherë të hapur, gjithjthnjë në funksion të turizmit kulturor dhe të jetës aktive diktuar nga rregullat e ekonomisë së tregut.

Ky edicion është më i madhi në historinë e organizimit të kësaj veprimtarie. Në të marrin pjesë 1300 artistë nga Shqipëria dhe nga të gjitha trevat dhe komunitetet shqiptare në botë të cilët do të prezantojnë me seriozitet të gjitha vlerat e shkëlqyera të folklorit tradicional shqiptar.

Kjo veprimtari zhvillohet edhe në kuadrin e 29 shtatorit, Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, duke sensibilizuar të gjithë faktorët që kanë përgjegjësi shtetërore dhe shoqërore për ruajtjen dhe jetëzimin e trashëgimisë sonë kulturore në mbrojtje të identitetit tonë kombëtar.

Falenderoj Qeverinë dhe veçanërisht Kryeministrin, Zotin Sali Berisha, që në cilësinë e Presidentit të Nderit të Festivalit është angazhuar maksimalisht që kjo veprimtari të jetë më e madhja dhe më e rëndësishmja në aspektin kulturor në vend, falenderoj gjithashtu institucionet shtetërore, pushtetin vendor në Gjirokastrë për seriozitetin dhe mikpritjen tradicionale që po i bëjnë këtij festivali, duke e kthyer muajin shtator në muajin e

këngës, valles e melodisë popullore, në muajin e festës kombëtare të trashëgimisë shpirtërore shqiptare.

Duke ju uruar organizatorëve dhe artistëve pjesmarrës suksese në promovimin dhe popullarizimin e artit tonë tradicional e deklaroj të hapur Festën e Madhe të Folklorit Shqiptar, Festivalin Folklorik Kombëtar, Gjirokastrë 2009.

Prezantohet juria e FFK, kryetar zgjidhet Akademiku Vasil Tole

Në ditën e parë të hapjes së FFK Gjirokastra 2009, juria e përzgjedhur sipas kriterëve të përcaktuara në “Statutin e FFK” është prezatuar para pjestarëve të Komitetit Organizator në një nga zyrat e Zyrës për Administrimin e Koordinimin e Qytetit Muze të Gjirokastrës. Drejtori i Përgjithshëm i edicionit të nëntë të këtij festivali, zoti Esat Ruka pasi ka uruar për punë të mbarë të shtatë antarët e përzgjedhur të jurisë, ai i ka njohur ata me punën parapërgatitore me grupet konkurse, skenën e festivalit dhe masat për akomodim të artistëve, ndërkohë që ka ofruar

gadishmërin e tij për bashkëpunim në mbarëvajtjen e festivalit. Anëtarë të Jurisë së FFK Gjirokastra 2009 janë: Prof. dr. Afërdita Onuzi, Akademik, Prof. dr. Vasil S. Tole, Rexhep Çeliku, Mjeshtër i Madh, Prof. dr. Miaser Dibra, Zef Çoba kompozitor, Prof. Rexhep Muni-shi dhe Lejla Agolli kompozitore. Në vazhdim të procedurave të përcaktuara nga amendamentet e “Statutit të FFK”, pjestarët e jurisë, në prani të një pjese të antarëve të Komitetit Organizator, shtatë antarët e jurisë kanë zhvilluar mbledhjet e tyre të parë për të zgjedhur kryetarin e jurisë. Pas votimit të fshehtë, me shumicë votash Akademiku Prof. dr. Vasil S. Tole është zgjedhur Kryetar i Jurisë së FFK Gjirokastra 2009.

VLERËSIMET E JURISË SË FFK GJIROKASTËR 2009

I. Mbështetur në mendimet e anëtarëve të jurisë së FFK Gjirokastrë 2009, për një përfaqësim më të mirë në zharnëve folklorike, grupëmoshave e divensitetit kulturor janë përcaktuar për të ndarë këto çmime:



Iso-polifonia fq. 5

1. Çmimi i parë (në shkallë qarku) e fiton Qarku i Shkodres
2. Çmimi i dytë (në shkallë qarku) e fiton Qarku i Gjirokastrës
3. Çmimi i dytë (në shkallë qarku) e fiton Grupi Kosova 2
4. Çmimi i tretë (në shkallë qarku) e fiton Qarku i Elbasanit
5. Çmimi i tretë (në shkallë qarku) e Fiton Qarku i Lezhës

II. Çmime për grupe zharnesh:

1. Orkestrinës më të mirë në veglat tradicionale. Qarku i Dibres me Orkestrën e Matit.
2. Orkestrinës më të mirë të muzikës popullore qytetare. Qarku i Korçës Per sazet.
3. Grupit më të mirë të iso-polifonisë labe. Grupi i Vlores
4. Grupit më të mirë të iso-polifonisë toske. Qarku I Beratit per Iso-polifonine e Skraparit.
5. Ritualit më i mirë i festivalit folklorik kombëtar. Qarku i Tiranës
6. Grupit më të mirë të valleve të burrave. Qarku i Fierit me Vallën e Brezave.
7. Grupit më të mirë të valleve të grave. Qarku I Durrësit me vallën e Fluturave.
8. Grupit për paraqitjen më të mirë të veshjeve popullore. Grupi I Kuksit
9. Për diversitetin kulturor. Vallja E DROPULLIT, Grupi I Gjirokastrës

III. Çmime për individë:

1. Rapsodi/ët më i/të mirë të FFK. Sherif Dervishi, Myfterin Uka (Diber)
2. Intepretuesi/a më i/e mirë e FFK. Benis Lekdodaj (Vlore), Vallja Came
3. Lahutari/et më i/të mirë i FFK. Lahutari 99 vjecar Gjok Nanaj, Lezhe
4. Për këngëtimi e këngës së majekrahut. Grupi i Tropojës
5. Instrumentisti më i mirë i FFK në vegël aerofone). Zog Sheta.
6. Instrumentisti më i mirë i FFK në vegël kordofone). Aurel Qirio
7. Këngëtari/a më i/e mirë i/e FFK. ---Eleni Merkuri i grupit te Himares dhe Veiz Kociu i grupit te Lazaratit.

Marrë nga faqja zyrtare: www.mtkrs.gov.al



Homazh për jetën dhe veprën e Prof. Ramadan Sokolit



Prof. Ramadan Sokoli (14 qershor 1920- 11 mars 2008)

“SHUHET RILINDASI I FUNDIT”

Prof. Ramadan Sokoli nismëtari i studimeve të iso-polifonisë popullore shqiptare

Me hidhërim të thellë, më 11 Mars 2008, populli shqiptar dhe gjithë trashëgimia e jonë kulturore shqiptare përcolli për në banesën e fundit Prof. Ramadan Sokolin, personalitetin më të shquar të studimeve në fushën e trashëgimisë shpirtërore shqiptare, themeluesin e shkencës sonë etnomuzikologjike. Prof. Sokoli lindi në qytetin e Shkodrës më 14 Qershor 1920 në familjen patriotike dhe atdhetare të Sokolave. Arsimin fillor dhe të mesëm i kryen në qytetin e Shkodrës. Në vitet 1940-1944 kryen studimet e larta muzikore në Firence, Itali. Pas çlirimit të vendit kryen detyrën e pedagogut të Folklorit Muzikor Shqiptar në Liceun Artistik dhe Institutin e Lartë të Arteve, degë të cilën e krijoi ai vetë. Nga vitet 1946-1950, Prof. Sokoli burgoset nga diktatura komuniste duke dashur të thyejë karakterin e pathyeshëm të këtij burri të rrallë të Shqipërisë në shek. XX, pjesë e kalvarit të dënimeve që morrën edhe pjestarë të tjerë të familjes së Tij gjatë atyre viteve.

Deri në botimet e para të Prof. Sokolit, të cilat filluan rreth viteve 1950, etnomuzikologjia shqiptare nuk ekzistonte. Ndër gjithë opusin e tij krijues punimet në folklorin muzikor e përkatësisht në etnomuzikologji zënë kryet e vendit, vepra të cilat janë ndër të tjera edhe punimet themeluese të etnomuzikologjisë shqiptare në përgjithësi. Në një lloj kuptimi gjithë kontributi etnomuzikologjik i prof. Sokolit është si një enciklopedi e mbartjes dhe e shpjegimit të fenomenit të folklorit muzikor shqiptar në kohë dhe hapësirë shumë të gjerë. Këtë e konstatojnë studiuesit, muziktarët, srtudentët dhe nxënësit e muzikës, për të cilët ai orientoi dhe futi në strukturën e shkollës qysh në vitet '50 të shek. XX, si një diçka të natyrshme lëndën e Folklorit Muzikor Shqiptar. Ishte një hap mendimtari ky, ai që përcaktoi edhe orientimin prej vlerave tona shekullore, që shkolla e re shqiptare duhej detyrimisht t'i ndiqte. Në vitet 1957 dhe 1959, përmes organizimit të ekspeditave të përbashkëta ndërkombëtare me institutet kërkimore shkencore të Gjermanisë dhe Rumanisë, ndikoi së tepërmi në popullarizimin e vlerave të trashëgimisë



Homazhet në nderim të Prof. Ramadan Sokolit në Muzeun Historik Kombëtar

sonë kulturore, ndër to edhe të folklorit muzikor çam, në Evropë e më gjerë.


Vlerat e veprës së Prof. Sokolit janë konturuar së bashku me rritjen profesionale, shkencore dhe artistike të autorit të saj. Ajo ç'ka i ka ngjizur ato në një unitet të vetëm rrezatues, është shpirti, puna dhe përkushtimi i tij prej rilindasi. Falë kontributit të tij të jashtëzakonshëm dhe interpretimeve të tij shkencore, kanë folur shqip zbulimet e arkeologjisë sonë muzikore, të mëdhenjtë Niketë Dardani, Jan Kukuzeli e Danush Lapacaja, figurën e Skënderbeut në muzikë, si dhe janë dhënë përgjigje thelbësore për mënyrën e organizimit dhe tipologjitë bazë të folklorit muzikor shqiptar duke filluar prej veglave tona muzikore e deri tek përgjigje të komplikuara të origjinës së muzikës sonë popullore, këtej e matanë kufirit.

Po kaq të rëndësishme e konsiderojmë edhe krijimtarinë e tij muzikore, e cila ka në thelb orientimin për nga vlerat e etnomuzikës; punimet e tij muzikologjike në të cilat influenca e etnomuzikës është e drejtpërdrejtë, e po aq konstatimi se edhe në studimet e tij albanologjike, vështrimi etnomuzikologjik i problemit albanologjik është më se origjinal. Janë të paharrueshme krijimet e tij muzikore të të gjitha llojeve dhe gjinive, duke kujtuar ndër to këngët aq të njohura si: *“Turtulleshë”*, *“Blegron delja”*, *“Luleja me erë”* etj.

Puna e tij e jashtëzakonshme u krye pa mbështetjen e duhur dhe kujdesin e veçantë që duhet të kishte ky kollos i trashëgimisë sonë shpirtërore. E gjithë vepra e tij mban vetëm vulën e punës së tij të përveçme, e kryer jashtë ambjenteve të institucioneve zyrtare të studimit të traditave, por nën kujdesin e veçantë të zonjës Lili, gruas së tij të dashur dhe të përkushtuar ndaj Tij deri në çastet e fundit, kur edhe ajo u nda nga jeta disa vjet më parë. Prof. Sokoli i ka kushtuar veprën *“16 Shekuj”*, dashurisë dhe kontributit të Saj.

Me shumë vonesë, vetëm në vitin 1995 i jepet titulli i Profesorit, ndërsa me 2002 i akordohet nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, titulli *“Mjeshtër i Madh”*. Me vdekjen e Tij, ndahemi me të vetëm fizikisht. Vepra e tij studimore dhe muzikore tashmë është pjesë e identitetit kulturor europian të shqiptarëve. Për jetën dhe veprën e Tij, muzikologu Osman Xhatufa ka shkruar monografinë *“Ramadan Sokoli, jeta dhe vepra”* në vitin 2004. Emri i tij renditet në enciklopeditë e huaja krahas më të mëdhenjve etnomuzikologë të botës. Krijimtaria e tij studimore vazhdoi deri në çastet e fundit të jetës. Me veprën e Tij të pamatë, Prof. Ramadan Sokoli është bërë pjesë e panteonit të personaliteteve më të shquara të kombit tonë.

I paharruar Profesori YNË. U prefsh në paqe!



Botimet kryesore të Prof. Ramadan Sokolit:

- “Les danses populaires et les instruments musicaux du peuple albanais”*, Tiranë, 1958;
- “*Albanske narodnie pesni*”, Tiranë 1965;
- “*Figura të ndritura*”, Tiranë, 1965;
- “*Folklori muzikor shqiptar-morfologjia*”, Tiranë, 1965;
- “*Chansons populaires albanais*”, Tiranë, 1966;
- “*Metodë për fyell*”, Tiranë, 1970;
- “*Vallet dhe muzika e të parëve tanë*”, Tiranë, 1971;
- “*Folklori muzikor shqiptar-organografia*”, Tiranë, 1975, 1984, 1987, 1991;
- “*Figura e Skënderbeut në muzikë*”, Tiranë, 1978;
- “*Gjurmime folklorike*”, Tiranë, 1982;
- “*Këngë patriotike*”, Tiranë, 1985;
- “*Veglat muzikore të popullit shqiptar*”, me bashkautor, Tiranë, 1991;
- “*16 shekuj*”, Tiranë, 1995;
- “*Antifonari i durrsakut Gjergj Danush Lapacaja*”, Tiranë, 2000; “*Gojëdhana dhe përrallëza të botës shqiptare*”, Tiranë, 2000
- “*Përtej 16 Shekujve*”, Tiranë, 2002
- “*20 miniatura pianistike*”, Tiranë, 2002
- “*Krijime dhe flijime*”, Tiranë, 2003 si dhe qindra artikuj në shtypin periodik shqiptar e të huaj.

Literaturë kushtuar jetës dhe veprës së Prof. Ramadan Sokolit:

- Siliqi, Lllazar. “*Kompozitori, folkloristi dhe muzikologu ynë i respektuar*”, “*Nëndori*”, 1990, nr. 8, fq. 125-130;
- Gjata Trim, “*Portreti i një intelektualit*”, “*Bota shqiptare*”, 1993, nr. 4, 1993;
- Bytyçi Enver, “*Ramadan Sokoli, legjenda e gjallë e kulturës shqiptare*”, *Koha*, Tiranë, 2001, nr. 60, 1 Gusht, fq. 27-31;
- Braho Esat., “*Ramadan Sokoli, muzikologu dhe folkloristi i shquar*”, *Liria*, Tiranë, 2001, nr. 475, 12 tetor, fq. 10-11;
- Munishi, Rexhep “*Identiteti muzikor*”, Prishtinë, 2001, fq.106-109; Xhatufa Osman, “*Ramadan Sokoli, jeta dhe vepra*”, Tiranë, 2004 etj.

“Grupe të shquara të Iso-polifonisë Shqiptare”

Grupi i “Pleqeve të Gjirokastrës”.

Grupi i pleqve është grupi popullor iso polifonik më i shquar i qytetit muze të Gjirokastrës i viteve 1940-1980. Ky grup njihet ndryshe me emrin “Grupi i pleqve të Gjirokastrës”. Grupi përbëhet nga Xhevat Avdalli (1910-1992)-marrës, Nustret Çarçani, Javer Erindi (1915) dhe Tolo Njocko (1914-) –*kthyesa*, Skënder Tushe (1917-)-*hedhës*, si dhe *iso* e përbërë nga Jonuz Shehu, Demo Çenko, Haseni Kore, Beadin Dobi, Kamber Dudumi, Seit Rondo, Reuf Jaupi (1923) Vehip Çarçani dhe Braho Çoçoli. U shqua për një repertor shumë të gjerë të këngëve polifonike nga të gjitha trevat e Labërisë. Në mënyrë të veçantë skalitën këngën iso polifonike qytetare të dasmës dhe atë që njihet si “*pleqërishte*”. Ndër këngët e njohura të tyre janë “Ç’u mbush mali”, “*Birbilenjtë trembëdhjetë*”, “*Kurvelesh e Gegëri*” etj. Si grup kanë marrë pjesë në shumë aktivitete të rëndësishme kombëtare duke përfshirë edhe F.F.K. Kanë kënduar drejtpërsëdrejti në valët e Radio-Gjirokastrës nga vitet ’50 deri në fund të viteve ‘70 të shek. XX.. Në ndonjë rast kanë kënduar të shoqëruar edhe nga formacioni i sazeve. Fama e tyre është përjetuar edhe në thënien e mëposhtme: *T’ja merrte Xhevat Avdalli, t’ja kthente Nustret Çarçani e t’ja hidhte Xhipe Mezini, s’kishte më këngë në Gjirokastrë*. Xhevat Avdalli mbahet mend se këndonte edhe këngë popullore të cilave ja merrte dhe ja kthente po vetë. Regjistrimet muzikore të tyre gjenden pranë Radio-Tiranës dhe Radio-Gjirokastrës. Në rubrikën EJ (Erotike Jugu) të fonotekës së Radio-Tiranës gjenden edhe këto këngë IPL të regjistruara prej grupit të Pleqve të Gjirokastrës:

viti 1956, nr. 14-“*Një ditë nga mali dola*”; viti 1956, nr. 16-“*Ç’u mbush mali plot me rrush*”; viti 1957, nr. 17-“*Ç’u ngreç që me natë*”.viti 1957, nr. 18-“*Mun te sheshi mun te molla*”; viti 1959, nr. 30/2-“*Thëllënzë bigë më bigë*”; viti 1962, nr. 33-“*Dola një ditë nga mali*”.viti 1966, nr. 87-“*Kur dola në lëmë*”; viti 1966, nr. 87/1-“*Në moshën 27 vjeç*”; viti 1966, nr. 91-“*Hiqe vallen shtruar-o*”.



Një tjetër grup i dëgjuar iso polifonik nga Gjirokastra, përmendet edhe ai i familjes Daci nga lagja Manalat, grupi iso-polifonik i lagjes Cfakë nga familja Bixhakaj etj. Në një foto të vitit 1938, është grupi iso polifonik i lagjes Cfakë i veshur me rroba popullore, i përbërë nga Mujo Bebeci, Kamber Kasi, Kamber Shehu, Mufti Lanko, Avduall Erindi, Fejzo Kasi, Mufti Sinani, Selfo Bajo, Jonuz Kasi, Muharrem Lekloti dhe Fail Demo.

Lit: Dino Thanas, “*Përcjellje për Xhevat Avdallin*”, Zëri i Popullit, 1992, nr. 306, dt. 19 Dhjetor; Vasil S. Tole, “*Folklori muzikor-polifonia shqiptare*”, Vol. I, Tiranë, 1999; Naxhi Kasoruh, “*Gjirokastra e festivaleve*”, Tiranë 2000; Gazeta “*Gjirokastra*”, nr 10, Shtator, 2000; Dino Thanas, “*Xhevat Avdalli dhe Laver Bariu*”, Tiranë, 2004 etj.

“Novruz Nure-Lulushi dhe sazet iso-polifonike të Korçës”.

Lulushi (Korçë 23.03.1954- Korçë † 23.04.1990), është mjeshtër i shquar në interpretimin e muzikës iso- polifonike të Korçës, në gërnëtë, në gjysmën e dytë të shek. XX. Ai u formua në një familje muziktarësh popullorë dhe që në vogëli luante në vegla muzikore si fizarmonika dhe klarineta. Më pas, i përfshirë në “Ansamblin Skënderbeu” të qytetit të Korçës, Lulushi luajti pjesën më të madhe të muzikës popullore me vegla të Shqipërisë Juglindore. Lulushi, u dallua për një lojë virtuoze në gërnëtë, kjo e shoqëruar me një ëmbëlsi të rrallë interpretimi, e cila buronte nga ndjesia e tij e lindur mbi tingullin popullor të gërnëtës.

Prej shumë vitesh në muzikën qytetare IPT të Korçës, gërnëtarët e shquar dalloheshin nga njëri tjetri, jo më shumë nga dallimet e repertorit që luanin, por nga veçoritë individuale që ata implementonin mbi strukturën e pjesëve të njohura popullore. Kështu, në shumë raste një gërnëtaxhiu nga gjithë jeta e tij i kujtohej vetëm një veçori që e kishte vetëm ai, dhe që kjo e bënte të dallohej nga të tjerët. Pjesa tjetër mund të ishte më fatlume ose fatkeqe. Atyre më të mirëve vazhdojnë akoma edhe kësaj dite t’u luhen pjesët, duke i quajtur “*sipas Jonuzit*”, apo “*me gishtin e Qerimit*” etj. Lulushi rreshtohet në majën e gërnëtarëve që ka njohur muzika popullore IP e Korçës.

Përveç dhjetra interpretimeve virtuoze që njihen tani si “...të gërnëtës së Lulushit”, ai ka luajtur dhe ka lënë në fondin e artë të muzikës me saze atë që sot njihet si “Kabaja e Lulushit në Sol”, luajtur për herë të parë në F.F.K të Gjirokastrës, 1983. Megjithëse i ri në moshë, për Lulushin në popull thuhet se: “*Është i madh si Çobani dhe Laveri*”. Arsyet se pse populli e ka vlerësuar kaq shumë, lidhen pikërisht me faktin se Lulushi pasi thithi të gjithë atë repertor të artë muzikor të krijuar nga mjeshttrat popullorë përpara tij, u përpoq që të arrinte rezultate të tjera, pikërisht duke përdorur veglan e gërnëtës si një vegël popullore shqiptare. Me një mjeshtëri të pashoqe, ai aplikoi teknika të ndryshme të interpretimit të veglave popullore

në gërnëtë. Kjo i dha tingullit të veglës së tij një individualitet aq të veçantë, sa ç’do vesh njerëzor, sado pak i ambjentuar me muzikën popullore, do të mund të dallonte timbrikën dhe ngjyrën karakteristike të tij.

Kjo përvojë e mjeshtrove si Çobani, Lulushi, Laveri etj, është një fushë e hapur për studiuesit e muzikës popullore, të cilët duhet të nxjerrin konkluzione se si është e mundur që vegla të importuara si klarineta, të arrijnë të fitojnë në duart e këtyre mjeshtrove atributet e një vegle popullore shqiptare. Pikërisht koncepti i tingullit popullor të gërnëtës realizuar prej tyre është një nga veçoritë të cilat ndihmojnë në diferencimin e muzikës sonë të vërtetë popullore prej kulturave apo dhe pseudokulturave. Ka qenë tri herë laureat i Festivaleve Folklorike Kombetare në Gjirokastrë duke filluar nga 1978, 1983, 1988. Nderohet me çmim të veçantë në Samsun të Turqisë më 1987, e po ashtu mjeshtër nderi në Prevezë-Greqi më 1984 dhe 1989. Nuk ka realizuar ndonjë kasetë apo C.D. të plotë, por një pjesë e madhe e regjistrimeve të tij i janë bashkëngjitur repertorit muzikor të këngëtarëve popullorë Lindita Thodhori, Sotiraq Vangjeli dhe Eli Fara. Sazet e tij përbëheshin nga 2 gërneta, 1 violinë, 1 fyell, 2 llauta, 1 fizarmonikë dhe 1 dajre. Vdiq në moshën 46 vjeçare me 23 prill 1990 nga një sëmundje e rëndë.



“Projekti për ruajtjen dhe mbrojtjen e Iso-polifonisë popullore shqiptare”

“Ruajtja dhe mbrojtja e iso-polifonisë shqiptare”

Projekti për ruajtjen dhe mbrojtjen e iso-polifonisë popullore shqiptare, zhvillohet në kuadër të vlerësimit që i bëhet “*Kryeveprave të njerëzimit*”, të mbrojtura nga UNESCO, vend të cilin iso-polifonia popullore shqiptare e ka zënë prej datës 25 Nëntor, 2005. Ky projekt, i cili çelët zyrtarisht me promovimin e Odave të iso-polifonisë, në qytetin e Përmetit më 31 Mars, 2008, synon të garantojë këtë traditë të jashtëzakonshme të ekzistencës së shumëzërëshit muzikor popullor, duke u përqëndruar veçanërisht në transmetimin e saj tek brezi më i ri. Aktivitetet e planifikuara në kuadrin e këtij projekti përfshijnë: nxitjen e transmetimit nëpërmjet ngritjes së Odave tradicionale të iso-polifonisë (në Përmet, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë); duke krijuar një Regjistër të debutuesve, duke dhënë trajnim për Dixhitalizimin e trashëgimisë shpirtërore si dhe duke promovuar publikime të shkruara dhe elektronike, siç është rasti i gazetës “*Iso-polifonia*”.

Siç dihet, nga pikëpamja etno-kulturore, iso-polifonia është tipike për dy zona të mëdha, Toskëria dhe Labëria. Si polifonia labe edhe ajo toske janë të pasura në formë dhe përmbajtje, duke përfshirë krijime muzikore nga lindja deri në vdekje si: ninulla, vajtimet, baladat, këngët historike, këngët lirike, këngët humoristike, këngët e kurbetit, një shumicë gjinish të muzikës me vegla si Kabaja, valet etj.

Deri në fund të viteve 1990 të shek. XX-të, iso-polifonia në Shqipërinë Jugore është transmetuar në rrugë tradicionale nga prindërit tek fëmijët, por duket se këto 20 vitet e fundit, kjo mënyrë transmetimi u prish kryesisht për shkak



të vështirësive ekonomike dhe emigrimeve dhe migrimeve në shkallë të gjerë. Pjesa më e madhe e fshatrave dhe qyteteve në Shqipërinë Jugore kanë sot grupe iso-polifonike vokale dhe ato me vegla. Këto grupe folklorike ftohen në festa familjare dhe shoqërore si dhe marrin pjesë rregullisht në ngjarje dhe festivale të ndryshme vendore dhe kombëtare si: Festivali Kombëtar Folklorik Tipologjik i Sazeve të Shqipërisë së Jugut, në Korçë; Festivali Kombëtar Folklorik i Iso-polifonisë, në Vlorë; Festivali i Fyellit Magjik, në Butrint, Sarandë; Festivali Kombëtar Folklorik i Instrumenteve, në Gjirokastrë; si dhe Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës, që zhvillohet çdo katër vjet në këtë qytet-muze të shpallur nga Unesco si “*Pasuri kulturore e njerëzimit*”.

Gjatë dekadave të fundit, rritja modeste e turizmit kulturor dhe interesi në rritje i studiuesve në këtë traditë folklorike unike kanë kontribuar deri në një farë mase për një rizgjim të iso-polifonisë shqiptare. Megjithatë, tradita ndikohet negativisht nga varfëria në zonat rurale dhe mungesa e mbështetjes financiare për bartësit dhe debutuesit e saj, duke kërcënuar transmetimin e repertorit të pasur të këngëve



dhe teknikave muzikore të kësaj dukurie të jashtëzakonshme. Eksodi i të rinjve drejt qyteteve dhe jashtë shtetit, në kërkim të punëve e përforcon këtë rrezik. Në këto rrethana, vazhdimësia e iso-polifonisë shqiptare ruhet kryesisht nga këto grupe folklorike, dhe jo më nga strukturat familjare tradicionale, të cilat ende e kryejnë këtë funksion por nuk mund që ta garantojnë më atë. Duke marrë parasysh sa më sipër, ky projekt synon nxitjen dhe përtëritjen e iso-polifonisë duke përshtatur mënyrat tradicionale të transmetimit me realitetet e reja shoqërore dhe mënyrat e jetesës. Për këte arsye, përbërësit kryesorë të projektit janë: trajnimi dhe transmetimi i aftësive dhe ekspertizës; dokumentimi dhe inventarizimi; rritja e ndërgjegjësimit public ndaj kësaj vlere.

Në tërësi, përfituesit kryesorë të projektit janë bartësit dhe debutuesit e iso-polifonisë shqiptare dhe, veçanërisht, rinia e cila do të mësojë këngët tradicionale, teknikat dhe stilet e debutimit. Gjithashtu përfitimet priten të shtrihen edhe tek nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, me ndihmën e një fushate ndërgjegjësimiti në media të ndryshme. Më tej, përfituesit e tjerë të projektit janë studiuesit e iso-polifonisë shqiptare, specialistët e trashëgimisë kulturore jomateriale si dhe publiku i gjerë. Besojmë se ky projekt të shërbejë si model për projekte ose aktivitete të tjera që duhet të

organizohen dhe nxiten nga specialistët shqiptarë të trashëgimisë kulturore shpirtërore në nivele lokal dhe qendror. Në këtë pike, besojmë se do të ndikohet sadopak në riformatimin e politikave kulturore të shtetit shqiptar ndaj vlerave të trashëgimisë kulturore shpirtërore. Projekti do të ndikojë gjithashtu në nxitjen dhe transmetimin, veçanërisht ndërmjet brezave, të iso-polifonisë shqiptare, duke përshtatur mënyrat tradicionale me realitetet e reja sociale; në ndërtimin e kapaciteteve vendore dhe kombëtare për garantimin e transmetimit të iso-polifonisë dhe trashëgimisë kulturore jomateriale shqiptare në përgjithësi, nëpërmjet mbështetjes dhe zhvillimit të rrjeteve të debutuesve dhe kujdestarëve dhe hartimit të Inventarit të Debutuesve të isopolifonisë shqiptare; si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit public ndaj iso-polifonisë shqiptare si dhe në rizgjimimin e interesit tek të rinjtë për të. Projekti do të zbatohet nga Këshilli i Muzikës Shqiptare, anëtar i IMC/UNESCO-s. Për të mundësuar projektin u aprovua VKM Nr. 82, datë 19.01.2007 *“Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe UNESCO-s, për mbështetjen e projektit “Mbrotjtja e iso-polifonisë shqiptare, Kryevepër e Unesco-s dhe trashëgimi gojore e shpirtërore e njerëzimit”*; si dhe u nënshkrua *“Marrëveshja mes UNESCO-s dhe Ministrisë*

së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve datë 25. 07. 2007”.

Pritet që si rezultat i këtij projekti, të arrihet të konstatohet një interes më i madh kundrejt muzikës iso-polifonike nga të rinjtë shqiptarë. Kjo do të shkaktojë ripërtëritjen e formave të përcjelljes së iso-polifonisë, duke mundësuar edhe vazhdimësinë e traditës ekzistuese. Materialet e projektit do të jenë online në webin zyrtar të iso-polifonisë:

www.isopolifonia.com



“Aspekte ligjore të mbrojtjes së iso-polifonisë”



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE
Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore

UDHEZIM

Nr.1, date 09.12.2005

PER
RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E ISO-POLIFONISE SHQIPTARE

Drejtuar : **QENDRES KOMBETARE TE VEPRIMTARIVE FOLKLORIKE**
QARQEVE VLORE, ELBASAN, KORCE, GJIROKASTER, FIER, BERAT
17 BASHKIVE DHE 17 QENDRAVE KULTURORE
SEKSIONIT TE CIOOF-it PERMET

Për ruajtjen, studimin, promovimin dhe popullarizimin mbarëkombëtar të iso-polifonisë si vlerë e pamohueshme e trashëgimisë shpirtërore shqiptare, që tashmë është pjesë e “Kryeveprave të trashëgimisë orale të njerëzimit”, të mbrojtur nga UNESCO, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për ngritjen në një nivel më të lartë shkencor dhe artistik të punës në drejtim të njohjes e promovimit të iso-polifonisë, udhëzon dhe propozon marrjen e këtyre masave:

1. Pranë Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve do të ngrihet Bordi Këshillimor i Trashëgimisë Shpirtërore Shqiptare, për promovimin dhe menaxhimin e kësaj pasurisë shpirtërore të popullit shqiptar.
2. Pranë pushtetit vendor në nivel qarku, bashkie dhe komune të krijohen struktura që do të angazhohen për të ridimensionuar iso-polifoninë si një vlerë të trashëgimisë shpirtërore botërore, duke caktuar pranë këtyre institucioneve, brenda strukturave ekzistuese, të një specialisti përgjegjës, i cili do të merret me organizimin e veprimtarive dhe propagandimin e këtyre dukurive.
3. Qarku dhe Bashkia e qytetit të Vlorës në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Folklorike të organizojnë çdo vit në datat 25-28 nëntor, Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Iso-Polifonisë, në qytetin e Vlorës. Kjo veprimtari e rëndësishme


kombëtare të realizohet enkas për ruajtjen, propagandimin dhe kultivimin e traditës muzikore të iso-polifonisë, dhe të organizohet si një veprimtari multikulturore, ku të përfshihen edhe ekspozita e botimeve kushtuar iso-polifonisë, e CD-ve, videove, etj. me këngë polifonike, tryezave shkencore, etj.

4. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve do të mbështetë aktivitetet vendore kushtuar iso-polifonisë, si aktivitete të përvitëshme.
5. Për mirëorganizimin e punëve që lidhen me iso-polifoninë dhe koordinimin e tyre me pushtetin qendror, vendor dhe institucionet e specializuara shkencore, të krijohet “Rrjeti kombëtar i OJQ-ve të iso-polifonisë”, në bashkëpunim me Seksionin Shqiptar të CIOFF-it.
6. Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, përveç organizimit të Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar të Iso-Polifonisë, që zhvillohet çdo vit në qytetin e Vlorës, të parashikojë në buxhetin e saj edhe botime të veçanta për iso-polifoninë dhe dhënien e çmimeve për CD dhe librin më të mirë kushtuar asaj.
7. Qendrat Kulturore në qarqet Vlorë, Gjirokastrë, Berat, Korçë, Fier dhe Elbasan të angazhohen për veprimtari lokale, ekspozuese në muzetë lokale, shkencore, botuese dhe artistike, kushtuar iso-polifonisë si një vlerë e trashëgimisë shpirtërore botërore.

MINISTRI

BUJAR LESKAJ

“Botohet Enciklopedia e Iso-polifonisë popullore shqiptare”



Ambasadori Withers në fjalën e prezantimit të Enciklopedisë

Foto LSA



Ambasadorja Ries dhe Ministri i Kulturës B. Leskaj në ceremoninë e nënshkrimit të grantit në Ambasadën USA, Tiranë



Embassy of the United States of America

Tirana, Albania

August 20, 2007

Congratulations!

On behalf of former U.S. Ambassador to Albania Marcie B. Ries, I would like to congratulate you on the completion of this Encyclopedia. It is evident that the material has been collected and selected with passion and love for Albanian Iso-Polyphonic music.

I am very happy that the Ambassador's Fund for Cultural Preservation of the U.S. Department of State made possible the publication of the Encyclopedia of the Albanian Iso-Polyphonic Music. I am proud that this Program could help preserve an exceptionally beautiful and uniquely Albanian musical form, a Masterpiece of the Intangible Heritage of Humanity recognized by UNESCO.

The Encyclopedia will contribute to the education of Albania's future generations and instill appreciation and pride among Albania's youth in their cultural heritage. I am confident that it will also become a valuable resource for foreign musicians, ethnomusicologists and other scholars interested in Albania's musical heritage.

The United States Embassy is pleased to have supported this important project.

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Stephen A. Cristina".

Stephen A. Cristina
Chargè d'Affaires

Fjala përshëndetëse me rastin e prezantimit të botimit
“Enciklopedia e iso-polifonisë popullore shqiptare”,

Shkëlqesia Juaj Z. Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri,
Të nderuar Akademikë,
Të nderuar ministra, deputetë, miq e të ftuar,

Jam shumë i nderuar që sot, me cilësinë e autorit të *“Enciklopedisë së iso-polifonisë popullore shqiptare”*, dhe në emër të Këshillit të Muzikës Shqiptare, t’i shpreh falenderimet më të përzemërta atyre që e bënë të mundur këtë botim. Ky libër, mundësohet tërësisht përmes mbështetjes së plotë nga ana e Programit të Fondit të Ambasadorëve për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore, krijuar nga Kongresi i Sh.B.A. Me këtë rast, i shprehim Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri dhe nëpërmjet saj Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, falenderimet dhe mirënjohjen më të thellë për mbështetjen financiare dhe të gjithanshme të këtij botimi kushtuar iso-polifonisë popullore shqiptare.

Së dyti, kam kënaqësinë që t’ju informoj se në pikëpamje kronologjike, ky botim shkencor është i pari që i kushtohet analizës dhe popullarizimit në këtë formë të njërës prej *“Kryeveprave të trashëgimisë gojore të njerëzimit”*, të shpallura deri më tani nga Unesco. Si i tillë, ky model i relizuar nga Shqipëria, kushtuar iso-polifonisë, është mirëpritur nga të gjithë në Shqipëri e jashtë saj, pasi, përmes tij do të njihet dhe popullarizohet më shumë kjo kulturë e jashtëzakonshme, çmuar prej dy vjetësh si *“Kryevepër e trashëgimisë njerëzore”*.

Së treti, një mirënjohje të thellë për popullin shqiptar. Ishte Ai që e krijoi këtë kryevepër shpirtërore, të ngjizur prej gëzimit

të lindjes dhe të strukturuar prej dhimbjes së vdekjes. Ky është thelbi i kulturës iso-polifonike, një trashëgimi mijravjeçare e bashkësisë njerëzore, e cila ende interpretohet dhe jeton kur njerëzit mblidhen së bashku kokë më kokë dhe po së bashku e mbajnë gjallë atë. Për këtë arsye enciklopedia që kini sot në duar është dëshmia e vlerave që kanë krijuar këngëtarët, instrumentistët dhe rapsodët popullorë, valltarët dhe mjeshtrat duarartë të veglave muzikore; aty është pohimi se vlerat e iso-polifonisë tek shqiptarët, tek grekët, vlllehët dhe evgjitët janë shprehje e bashkë ekzistencës njerëzore; se iso-polifonia është mozaiku ynë kulturor i bashkëjetesës, i evidentuar edhe përmes veprave të studiuesve tanë e të huaj, gjatë gjithë historisë sonë, të vjetër e të re. Iso-polifonia, është gjithashtu shprehje e jetesës dhe mbijetesës së trashëgimisë kulturore shqiptare në përgjithësi, e cila është pasqyruar edhe në letërsinë tonë prej Naimit, Konicës, Nolit, Poradecit, Kutelit, Kadaresë e Agollit. Në *“Enciklopedinë e Iso-polifonisë”* ju do të shihni se iso-polifonia është tradicionale dhe moderne, pasi përmes vlerave të saj trashëgimia kulturore shqiptare është tashmë pjesë e mozaikut botëror të kulturës.

Së fundi një falenderim të përzemërt për gjithë bashkëpunëtorët e këtij botimi, redaktorët, përkthyesen, Muzën për CD-në e Enciklopedisë dhe shtëpinë botuese Uegen.

Ju faleminderit!



UNESCO dhe roli i saj për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore

UNESCO do të thotë organizata e kombeve të bashkuara për edukim, shkencë dhe culture. (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organisation). Për të krijuar togfjalëshin UNESCO, janë përdorur gërmat e fillimit të fjalëve. 60 vjet pas adoptimit, Kushtetuta e UNESCO-s mbetet ende në kohë një dokument i rëndësishëm e jetëgjatë. Unesco ofron shërbimet në fushat e veta të kompetencës: *në arsim, shkenca natyrore, shkenca shoqërore e njerëzore, kulturë dhe komunikim e informim*. Qëllimet për të cilat UNESCO u themelua mbeten të vlefshme, pavarësisht se disa nga drejtimet që sapo ishin konturuar në kohën e krijimit të saj janë bërë tashmë gjithnjë e më të rëndësishme, ndërkohë që disa drejtime të tjera kanë pësuar zbehje. Orientimi strategjik i UNESCO-s është që: “Si agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara, kontribuon për ndërtimin e paqes, zhdukjen e varfërisë, zhvillimin e qëndrueshëm e dialogun ndërkulturor, nëpërmjet arsimit, shkencave, kulturës, komunikimit dhe informimit”. Në drejtimin e vet strategjik, UNESCO qëndron e palëkundur në kërkim të ndërtimit të një kulture të paqes, si dhe zhvillimit e thellimit të mirëkuptimit të ndërsjelltë, pajtimit e dialogut.

Parimet dhe vlerat: UNESCO mbështetet në një platformë ku sfidat globale të njerëzimit trajtohen mbi bazën e barazisë ndërmjet Shteteve Anëtare. Duke pasur në themel parimet e universalitetit, diversitetit dhe dinjitetit, veprimet e UNESCO-s vazhdojnë të udhëhiqen nga një bashkësi vlerash të ndara, të cilat ngërthejnë drejtësinë, solidaritetin, tolerancën, barazinë, respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e grave, si dhe larminë kulturore, pluralizmin dhe parimet demokratike.

Misioni: Në procesin e përmbushjes së mandatit të vet, UNESCO përpiqet të fuqizojë shtyllat e ndërsjellta mbështetëse të paqes, zhvillimit të qëndrueshëm e të drejtave të njeriut, duke kontribuar për zhdukjen e varfërisë e nxitjen e dialogut ndërmjet qytetërimeve, kulturave e popujve.

Funksionet: Përmes përmbushjes së misionit të vet, UNESCO do të kryejë për bashkësinë ndërkombëtare pesë funksione të paracaktuara: laborator idesh, përcaktuese e standardeve, njësi kleringu, ndërtuese e kapaciteteve për fushat e veta të kompetencës në Shtetet Anëtare dhe katalizatore për bashkëpunimin ndërkombëtar. Bashkësia ndërkombëtare i ka besuar gjithashtu UNESCO-s një numër të konsiderueshëm përgjegjësish gjithëpërfshirëse prej Lidërsipit të cilat ndahen në tre kategori:

- UNESCO si një agjenci udhëheqëse e Kombeve të Bashkuara;
- UNESCO si Organizatë politikëbërëse;
- UNESCO si ruajtëse e listave universale.

Për më shumë rreth UNESCO-s vizitoni dhe www.unesco.org



Foto: Selia e UNESCO-s në Paris, Francë



Foto: Flamuri i UNESCO-s



“The Iso-polyphony is a highly elaborate musical genre mainly performed by the Tosks and Labs of Southern Albania. This mountainous region gave rise to a unique culture, in which music became an expression of cultural identity. With roots going back to Byzantine times, the mastery of this music lies not only in the musical structure, but also in the epic nature of the accompanying songs”

Discours de M. Koïchiro Matsuura, Directeur général de l’Organisation des Nations Unies pour l’éducation, la science et la culture (UNESCO) à l’occasion de la troisième proclamation des chefs-d’oeuvre du patrimoine oral et immatériel de l’humanité et de la remise des Prix Arirang, UNESCO, le 25 novembre 2005.


The Director-General of UNESCO, Koïchiro Matsuura, today proclaimed 43 new Masterpieces of the Oral and Intangible Heritages of Humanity. Traditional Indian performances of the Ramayana, the Ramlila, Japan’s Kabuki theatre, the Zambian Makishi Masquarade and the Samba of Roda (Brazil) are among the masterpieces proclaimed. This is UNESCO’s third proclamation of Masterpieces of the Oral and Intangible Heritage, an international distinction destined to raise public awareness of the value of this heritage, which includes popular and traditional oral forms of expression, music and dance, rituals and mythologies, knowledge and practices concerning the universe, know-how linked to traditional crafts, as well as cultural spaces. Often vulnerable, this heritage, a repository of cultural diversity, is essential to the identity of communities and peoples.

The 43 masterpieces proclaimed this year are*:

- **Albanian folk iso-polyphony** (Albania)

- Ahellil of Gourara (Algeria)
- Duduk Music (Armenia)
- Baul songs (Bangladesh)
- Processional giants and dragons in Belgium and France (Belgium and France)
- The mask dance of the drums from Drametse (Bhutan)
- Samba of Roda from Recôncavo Baiano (Brazil)
- The Bistritsa Babi (grandmothers of Bistritsa) – Archaic **polyphony**, dances and ritual practices from the Shoplouk region (Bulgaria)
- Sbek Thom, Khmer shadow theatre (Cambodia)
- The Art of Chinese Xinjiang Uyghur Muqam (China)
- The cultural space of Palenque de San Basilio (Colombia)
- Oxherding and oxcart tradition in Costa Rica (Costa Rica)
- Slovácko Verbuňk, Dance of recruits (Czech Republic)
- Cocolo dancing drama tradition (Dominican Republic)
- Rabinal Achí Ballet (Guatemala)
- Ramlila: the traditional performance of the Ramayana (India)
- Indonesian Kris (Indonesia)
- The A Tenore Song of the Sardinian pastoral culture (Italy)
- Kabuki (Japan)
- The cultural space of the Bedu in Petra and Wadi Rum (Jordan)
- Vimbuza Healing Dance (Malawi)
- Gule Wamkulu (Malawi, Mozambique and Zambia)
- Mak Yong (Malaysia)

The types of Albanian Folk Iso-polyphony



Iso polifonia: Iso-polyphony, or drone-based polyphony. IP is a fundamental musical phenomenon of South Albania, derived on the basis of a number of soloists singing one or more vocal parts above a supporting drone (*iso*) performed by a group of singers. According to Faik Konica: “the songs themselves are mournful and monotonous, but they are unique examples of an ancient folk music with parts sung independently, whereas in other places popular songs are sung in harmony... The songs are generally in three parts: while two men sing lines that are largely different though entirely interconnected, the group maintains a *sostenuto*, similar to a pedal point.”

Lab iso-polyphony: Alb. *Labe iso-polifonia*.

One of the subdivisions of Albanian IP.

Ency. With regard to the geographic extent of Labëria, according to Çabej: this name is applied to the southwestern area of the country, the border of which begins at the village of Lazarat, south of Gjirokastër. The eastern border extends from Lazarat along the Gjerë mountains and the southern part of the Picar mountains. From here it continues to the west of the River Vjosë, while the Tosk lands, in the strict sense of the word, lie to the right of the river. The border takes in the village of Mesaplik near Vlorë and continues along an imaginary line from Mesaplik to the neighbouring Kudhës; the western border is formed by the sea. The border between the IP of Myzeqe and Lab IP is at the village of Armen, on the left bank of the Vjosë. The

principal ethnographic zones encompassed by Labëria are: *Kurvelesh, Mesaplik, Drashovicë, Topallti, Treblovë, Gorisht, Kudhës, Lopës, Kardhiq, Rrëzomë, Bregdet, Dukat*. Lab singing style is also encountered in *Zagorie, Lunxhëri, Malëshovë, Rrëzë e Tepelenës, Dragot, Kras, Izvor, Buz, and Mallakastër*, zones which can be regarded as the periphery of Labëria. The Lab population is subdivided into “Christian Labs” (Rrëza e Tepelenës, Zagoria, Bregu i Detit) and “Muslim Labs” (the central population block). From the standpoint of the current administrative divisions, Labëria is constituted of the districts of Vlorë, Sarandë, Delvinë, Gjirokastër, Tepelenë and Mallakastër. With regard to IP, there are a number of ways of representing it and its musical expression. The singing of polyphony itself is perceived by the


people as mysterious and instinctive, and in general as a phenomenon that internally reflects nature, the voice, the night, and the soil of Labëria. According to Çabej: this viewpoint is mentioned previously in various works dealing with the songs of the highlands, especially in the south where certain elements of pastoral life have been preserved, with imitations of bells and natural sounds. According to popular tradition, it was sometimes said that there was another way of singing iso-polyphony, singing by night, when water was being taken from the well, or during other activities. For this reason in Labëria it is believed that the night is the source of song, since song at night, or singing at night, has no practical purpose. It is frequently said in Labëria that there is a “iso-polyphony of the land”, meaning the polyphony sung in the highlands, as well as a “polyphony of the sea”. This was noted by Çabej, when he asserted that the villages of Vlorë had, in common with Himara, a more forceful, violently surging manner of singing. Dugat, with its deeply sonorous melodies, Kuervelesh, Delvinë, Gjirokastër, Lunxheri and elsewhere are also centres of local strains of Lab song. Iso-polyphony is predominantly encountered among men, but also occurs among women, in almost every type and genre, including musical and poetic compositions with a mythological and ritual content, dances, ballads and historical songs, lyrics, lovesongs, songs of emigration, laments, doggerel, etc. Instrumental polyphony is also found, mainly performed on instruments which are polyphonic in construction, such as the *culadyjare*. Polyphony is sung at weddings, wakes, various festivals, before and after contests, in the countryside, etc. Finally, everyone knows that when two Labs get together they break into song.

Tosk iso-polyphony.

Alb. *Iso-polifonia Toske*. One of the sub-

divisions of Albanian iso-polyphony. Ency. The area in which IPT is sung stretches from the right bank of the River Vjosa to the River Shkumbin. The iso-polyphonic music of Përmet, Leskovik, Kolonjë, Korçë, Devoll, Mokrë, Oparit, Skrapar, Shpat, Myzeqe, Librazhd, Gramsh and Berat can more or less be regarded as a theme and variations, the theme being the Tosk pattern of polyphony. IPT may also be encountered beyond the borders of Albania, in the area known as ‘Tosk Macedonia’, which includes the Albanians inhabiting the eastern shores of Lake Prespa and the left bank of the Black Drin in the district of Struga, and who sing one, two or three voice songs. More precisely, it is found in the villages of Frëngovë, Ladorisht (Radonisht), Kolisht, Zagrajani, villages which lie in the direction of Upper Mokrë; in the villages of Prespa - Kranjë, Arvat, Gërncan, Belloceika e Poshtme, Belloceika e Sipërme, Nakolec, Lubojna, Asamati, which lie in the geographic zone on the border with Albania and Greece, and which are therefore popularly known as *Treshi*, as well as in the districts of Bitola and the village of Kishof, etc. Just as in IPL, Tosk iso-polyphony is sung by both men and women, and in almost every genre, including poetic compositions with mythological and ritual content, dances, ballads and historical songs, lyrics, love songs, songs of emigration, mourning, satires, etc. Iso-polyphony may be sung in any place and at any time, in joy and in grief. According to Çabej: I can best describe Tosk melody with the two adjectives elegiac and expansive. With regard to Tosk instrumental iso-polyphony, it should be noted that there are any number of folk groups playing polyphony on traditional instruments. The expressions *përmetarçe*, *kolonjarçe*, *devolliçe*, *myzeqarçe*, etc, signify local variations in the style of singing IPT. The Tosk style of iso-polyphony is also encountered in Çamëria.

CD Publications of Albanian Folk Iso-polyphony



Foreword by the Director-General of UNESCO for the CD project “Albanian Intangible Heritage in CD”

South-East Europe is known for its wide-ranging cultural diversity and a rich heritage, both tangible and intangible, much of which has yet to be discovered by the outside world. Traditional music is one of the main pillars of that heritage.






Situated at the crossroads of many cultures that have exerted their influence over the centuries, Albania presents a musical landscape of unusual variety that has survived periods of change and political upheaval and offers today’s generations a means of affirming their cultural identity.


Albanian traditional music is commonly divided into two major forms, which are vividly presented here in this 2-CD anthology: the polyphony typical of the South, and the predominantly monophonic traditions of the North. Both traditions have aroused the admiration of artists and ethnomusicologists from far beyond the nation’s frontiers.

This collection, expertly compiled by Vasil S. Tole, is a tribute to the beauty and distinctive character of Albania’s music. It takes us into a universe of heroic epics and ballads that retrace the country’s history; gentle lyrical songs and intimate laments or lullabies; ceremonial chants; and jocular songs too. The instruments heard on these CDs include the lahuta and the çifteli.

This project is a valuable addition to UNESCO’s action for the promotion of traditional music. The Organization is more than ever dedicated to safeguarding and promoting the intangible cultural heritage. Such a task can only be carried out in close partnership with peoples and communities wishing to preserve the tissue of their cultural identity by means of oral traditions and artistic expressions of every kind. This selection of traditional Albanian music lifts a corner of the veil that has for too long hidden a great musical legacy.

Koïchiro Matsuura





ISO-POLIPHONY

“Kryevepër e trashëgimisë gojore dhe shpirtërore të njerëzimit”, UNESCO

“A Masterpiece of oral and intangible heritage of humanity”

www.isopolifonia.com

Newsletter; Nëntor 2009, Nr. 1



Maksi Vela, pikurë "Grupi iso-polyfonik Lab"

Organ i përnuajshëm i Këshillit të Muzikës Shqiptare, antar i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës IMC/ UNESCO dhe seksionit Shqiptar të CIOFF-it.

Këshilli Botues

Kryetar Nderi:

Prof. Ramadan Sokoli

Kryetar i Këshillit Botues:

Akademik Vasil S. TOLE

Antarë:

Akademik Jorgo Bulo, Prof. Dr. Fatmir Hysi, Prof. Agron Xhagolli, Prof. Spiro Shituni (USA), Dr. Eno Koço (Angli), Prof. As. Josif Minga, Bardhyl Londo, Aleks Todhe,

Kolegjiumi i Redaksisë:

Engjël Serjani, Arian Avrazi, Ilir Dhuri, Lefter Cipa, Muhamet Tartari, Sejmen Gjokoli, Maksi Kulo, Thanas Dino, Shkëlqim Hajno, Shkëlqim Guçe,

Drejtor:

Niko Mihali

Faqosës:

Ilir Parangoni

Kontakt:

Këshilli i Muzikës Shqiptare:

e-mail: vasiltole@hotmail.com

cel: 0 69 210 5555 1

Seksioni shqiptar i Cioff-it:

E-mail: egjikassoc@albmail.com

Cel: 0 69 22 34986

Këshilli i Muzikës Shqiptare-KMSH është person juridik i regjistruar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë me nr. Akti 3074, me vendimin nr. 1784. K.M.SH-Albanian Music Council zyrtarisht njihet si Komiteti Nacional i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës (IMC)-UNESCO, në Shqipëri. (CIM/49.631)